



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Psikologji

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	3	4	5	9	10	11	14	15	18
Përgjigjja e saktë	C	C	B	D	B	A	A	B	B	D

Pyetjet me zhvillim

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë tetjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

1. C) Psikoanalitik

2. Model përgjigjeje:

a)

1. nuk lejon studiuesin të kuptojë lidhjet shkak-pasojë;
2. sjellja që vëzhgohet nuk mund të përsëritet sa herë dëshiron studiuesi;
3. ka vështirësi për t'u përdorur;
4. kërkon shumë kohë.

b)

1. lejon të bëhen parashikime të sakta nëse zhvillohet me korrektësi;
2. mund të zhvillohet në mjedis natyror dhe në laborator;
3. mund të përdoren disa ndryshore në të njejtën kohë;
4. grumbullon shumë informacion në kohë të shkurtër.

3 pikë Nëse shkruan saktë dy mangësi të metodës së vëzhgimit natyror dhe një përparësi të metodës së korrelacionit.

OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë një mangësi të metodës së vëzhgimit natyror dhe një përparësi të metodës së korrelacionit.

1 pikë Nëse shkruan një mangësi të metodës së vëzhgimit natyror.

1 pikë Nëse shkruan një përparësi të metodës së korrelacionit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

3. C) Sinaps

4. B) Ndikon në kujtesën e njeriut

5. D) Vlerësimi i suksesit

6. Model përgjigjeje:

- a) nxitshmëria fiziologjike;
- b) ndjenja subjektive;
- c) përbërsi kognitiv;
- d) përbërësi sjellor.

3 pikë Nëse shkruan tre përbërës të tjerë të emocioneve, përveç përbërësit sjellor.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy përbërës të tjerë të emocioneve, përveç përbërësit sjellor.

0 pikë Nëse shkruan një përbërës të tjerë të emocioneve, përveç përbërësit sjellor.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

7. Model përgjigjeje:

- a) regjistrohen impulset e shikimit/dëgjimit/prekjes/dhimbjes;
- b) kontrollon lëvizjet e vullnetshme;
- rregjistrimi i i ndijimeve/të prekjes/dhimbjes/temperaturës

3pikë Nëse shkruan nga një funksion për secilën kërkesë.

OSE

2pikë Nëse shkruan nga një funksion për dy prej kërkesave

1pikë Nëse shkruan një funksion për një të kërkesë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

8. Model përgjigjeje:

- a) besimi te vetvetja më shumë se te shërbimi profesional. Disa praktika dhe njohuri në këto raste janë të dobishme, por mos kërkimi i ndihmës së mjekëve mund të rrezikojë seriozisht shëndetin e personit
- b)
 - prirja e dëgjimit të rekomandimit të mjekut, sidomos për barnat. Kjo nuk ndodh për rekomandimet rreth dietës, ushtrimit fizik, qëndrimi ndaj substancave
 - mjeku dëgjohet me fanatizëm kur njeriu e ka punën pisk, dhe jo kur ka çrregullim kalimtar ose parandalues i sëmundjeve

2 pikë Nëse shkruan dy prej tipareve të sjelljeve të sëmurit.

OSE

1 pikë Nëse shkruan një prej tipareve të sjelljeve të sëmurit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

9. B) Sensoromotor

10. A) Idi:

11. A) Humanistët

12. Model përgjigjeje:

- a) familja(prindërit);
- b) shkolla(mësuesit);
- c) media(gazetarët);
- d) kleri;
- e) personalitete të caktuara; jeta
- f) shoqërore në tërësi;
- g) besimet stereotipe për djemtë dhe vajzat;
- h) pritshmëritë më të ulëta për femrat;
- i) tipat e roleve të fëmijëve në lojëra, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre nga agjentët kryesorë që marrin pjesë në formimin e identitetit gjinor.

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga agjentët kryesorë që marrin pjesë në formimin e identitetit gjinor.
1 pikë Nëse shkruan një nga agjentët kryesorë që marrin pjesë në formimin e identitetit gjinor.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

13. Model përgjigjeje:

- a) mjaft autonon(nuk dallon nga të rriturit e tjerë)
 b) është i zoti të zërë e ta mbajë shoqërinë
 c) i aftë të mendojë në mënyrë abstrakte

3 pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten nga ana:

-morale -sociale

-intelektuale

OSE

2pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten nga ana:

-morale -sociale

2 pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten nga ana:

-sociale

-intelektuale

2 pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten nga ana:

-morale

-intelektuale

1 pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten vetëm nga ana morale. **1**

pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten vetëm nga ana sociale

1 pikë Nëse shkruan saktë çfarë mendon adoleshenti për veten vetëm nga ana intelektuale

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

14. B) Inteligjenca

15. B) Gjëndjet e ndërgjegjes së ndryshuar shkaktohen nga mosfunksionimi i procesit të vëmendjes.

16. Model përgjigjeje:

- a) depresantët
 b) stimulantët
 c) opiatët
 d) psikodelikët

3 pikë Nëse shkruan tre nga grupet e drogave psikoaktive. **2**

pikë Nëse shkruan dy nga grupet e drogave psikoaktive. **1 pikë**

Nëse shkruan një nga grupet e drogave psikoaktive.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

17. Model përgjigjeje:

Kujtesa afatgjatë

Deklarative(faktet)		Procedura(aftësitë)
Semantike	Episodike	
OSE:		

- a) kodimi sipas kuptimit(kodim semantik)
 b) depoziton shumë informacion për kohë pa limit
 c) kapacitet pakufi
 d) ndihmon informacionin e ri
 e) sa më i organizuar sipas kategorive, aq më lehtë riprodhohet roli i
 f) sinjaleve të jashtëm etj.

4 pikë Nëse shkruan katër elemente thelbësorë të kujtesës afatgjatë.

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre elemente thelbësorë të kujtesës afatgjatë.

2 pikë Nëse shkruan dy elemente thelbësorë të kujtesës afatgjatë.

1 pikë Nëse shkruan një elemente thelbësorë të kujtesës afatgjatë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

18. D) Trajtimit biologjik

19. Model përgjigjeje:

a)

1. studiojnë sjelljen në aspektin emocional/njohës/social;
2. sigurojnë kushte dhe ambiente që individi të shprehet lirshëm;
3. ruajnë konfidencialitetin e individëve;
4. sigurojnë vlerësime psikologjike për të diagnostikuar pacientin;
5. realizojnë "terapinë e të folurit";
6. këshillojnë pacientët në periudha të vështira;
7. ndihmojnë të modifikojnë sjelljen e tyre në një sjellje të shëndetshme etj.

b)

- është mjek që jep receta mjeksore;
- parandalon diagnozën;
- trajton çrregullimet mendore/depresioni/psikoza/disfunzioni seksual/abuzimi me substancat/çrregullime të zhvillimit.

2 pikë Nëse shkruan një rol psikologut dhe një rol të psikiatrit

OSE

1 pikë Nëse shkruan një rol të psikologut

1 pikë Nëse shkruan një rol të psikiatrit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

20. Model përgjigjeje:

Përgjigje:

- a) lidhja e dëmtimit të personit me faktorë mjedisorë;
- b) mjedis pozitiv kuptimi dhe vlerësimi për klientët;
- c) ndihmojnë të pranohet vetvetja;
- d) ndërgjegjësojnë personat për pengesat që u dalin;
- e) eksplorojnë rrugë për rritjen e tyre;
- f) mundësojnë shikimin e vetes si qenie të papërsëritshme, me tipare pozitive etj.

4 pikë Nëse shkruan katër momente nga trajtimi i sjelljes jonormale sipas drejtimit humanist.

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre momente nga trajtimi i sjelljes jonormale sipas drejtimit humanist.

2 pikë Nëse shkruan dy momente nga trajtimi i sjelljes jonormale sipas drejtimit humanist.

1 pikë Nëse shkruan një moment nga trajtimi i sjelljes jonormale sipas drejtimit humanist.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare